

RAPORT

I HULUMTIMIT

**PËRMIRËSIMI I
PROGRAMEVE
STUDIMORE NË FUNKSION
TË KOMPETENCAVE
TË KËRKUARA NGA TREGU I
PUNËS – FAKULTETI I BIZNESIT**

**Përgatitur nga:
Prof. asoc. dr. Suada Ajdarpašić**

Shtator, 2026

UNIVERSITETI “HAXHI ZEKA”

FAKULTETI I BIZNESIT



**HULUMTIMI PËR PËRMIRËSIMIN E PROGRAMEVE
STUDIMORE NË FUNKSION TË KOMPETENCAVE TË
KËRKUARA NGA TREGU I PUNËS – FAKULTETI I
BIZNESIT**

Raport i hartuar nga Prof. asoc. dr. Suada Ajdarpašić

Prodekane për mësimdhënie dhe çështje akademike

Pejë, 2026

© Të gjitha të drejtat për përdorimin e raportit janë të rezervuara ekskluzivisht për Fakultetin e Biznesit, Universiteti “Haxhi Zeka”, Pejë.

***“Shifrat nuk janë thjesht përqindje;
ato janë zëri i një realiteti që kërkon
të kuptohet, të analizohet dhe të përmirësohet.”***

– S. Ajdarpašić

PËRMBAJTJA

1. HYRJE	7
1.1. KONTEKSTI DHE RËNDËSIA E HULUMTIMIT	8
1.2. PROBLEMI I HULUMTIMIT	8
1.3. NEVOJA PËR PËRSHTATJEN E PROGRAMEVE ME TREGUN E PUNËS	9
1.4. QËLLIMI I HULUMTIMIT	9
1.5. OBJEKTIVAT E HULUMTIMIT	9
1.6. PYETJET KËRKIMORE	10
1.7. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT	10
1.7.1. Dizajni, qasja dhe karakteri i hulumtimit	10
1.7.2. Popullacioni dhe mostra e hulumtimit	12
1.7.3. Instrumenti dhe procedura e mbledhjes së të dhënave	12
2. REZULTATET E HULUMTIMIT	14
Tabela 1. Struktura e respondentëve sipas gjinisë	14
Tabela 2. Struktura e respondentëve sipas grupmoshës	14
Tabela 3. Struktura e respondentëve sipas statusit profesional dhe akademik	15
Tabela 4. Vlerësimi i rëndësisë së kompetencave në tregun e punës	16
Tabela 5. Vlerësimi i përputhshmërisë së programeve studimore me kërkesat e tregut të punës ...	18
Tabela 6. Kompetencat në të cilat studentët perceptohen si më pak të përgatitur	19
Tabela 7. Fushat prioritare për përmirësimin e Fakultetit të Biznesit në funksion të tregut të punës	21
Tabela 8. Rëndësia e përshtatjes së vazhdueshme të programeve studimore me ndryshimet e tregut të punës	23
Tabela 9. Format e lidhjes së programeve të Fakultetit të Biznesit me tregun e punës	25

Tabela 10. Cili është ndryshimi më i rëndësishëm që Fakulteti i Biznesit në programet e tij duhet ta bëjë për të përgatitur më mirë studentët për tregun e punës?	26
2.1. Ndryshime dhe sugjerime shtesë për përmirësimin e programeve studimore.....	30
2.2. SWOT ANALIZA E PROGRAMEVE STUDIMORE TË FAKULTETIT TË BIZNESIT....	33
3. KONKLuzionET	35
4. REKOMANDIMET	37
5. KUFIZIMET E HULUMTIMIT	40
6. SHTOJCA	42

1. HYRJE

Ndryshimet e vazhdueshme në tregun e punës, zhvillimi teknologjik, digjitalizimi, proceset e inovacionit dhe transformimi i modeleve të biznesit kanë ndikuar ndjeshëm në llojin e njohurive, aftësive dhe kompetencave që kërkohen nga punëdhënësit. Në këtë kontekst, institucionet e arsimit të lartë përballen me nevojën që programet e tyre studimore të jenë në përputhje me zhvillimet e tregut të punës dhe të ofrojnë kompetenca që u mundësojnë të diplomuarve integrim më të suksesshëm në tregun profesional.

Relevanca dhe cilësia e programeve studimore nuk përcaktohen vetëm nga përmbajtja akademike, por edhe nga aftësia e tyre për t'iu përgjigjur kërkesave reale të sektorit publik dhe privat, zhvillimeve të industrisë dhe nevojave të punëdhënësve. Një nga sfidat kryesore të arsimit të lartë është pikërisht identifikimi i hendekut të mundshëm ndërmjet kompetencave që studentët fitojnë gjatë studimeve dhe kompetencave që kërkohen në praktikën profesionale. Për këtë arsye, bashkëpunimi dhe komunikimi i vazhdueshëm ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë dhe tregut të punës janë të rëndësishme për zhvillimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programeve studimore. Në këtë kontekst, është realizuar

“Hulumtimi për përmirësimin e programeve studimore në funksion të kompetencave të kërkuara nga tregu i punës”,

me qëllim të identifikimit të nevojave dhe pritshmërive të tregut të punës lidhur me njohuritë, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të posedojnë të diplomuarit. Hulumtimi synon të ofrojë të dhëna empirike që mund të shërbejnë si bazë për vlerësimin e relevancës së programeve ekzistuese dhe për orientimin e proceseve të rishikimit, përditësimit dhe zhvillimit të programeve të reja studimore.

Në mënyrë të veçantë, hulumtimi fokusohet në identifikimin e kompetencave profesionale dhe të transferueshme që konsiderohen më të rëndësishme nga punëdhënësit, përfshirë njohuritë profesionale, aftësitë digjitale, aftësitë analitike dhe komunikuese, zgjidhjen e problemeve, punën në ekip, kreativitetin, përshtatshmërinë dhe aftësinë për të përballuar ndryshimet në mjedisin e punës. Gjithashtu, hulumtimi synon të evidentojë fushat ku mund të ekzistojë mospërputhje ndërmjet kompetencave të ofruara përmes programeve studimore dhe kërkesave aktuale të punëdhënësve.

Rezultatet e këtij hulumtimi pritet të kontribuojnë në sigurimin e një baze të argumentuar për përmirësimin e programeve studimore, duke i orientuar ato më mirë drejt nevojave të tregut të punës dhe zhvillimeve të ardhshme profesionale. Në këtë mënyrë, hulumtimi mund të shërbejë si instrument për rritjen e relevancës së arsimit të lartë, përmirësimin e punësueshmërisë së të diplomuarve dhe forcimin e lidhjes ndërmjet universitetit dhe komunitetit të biznesit.

1.1. KONTEKSTI DHE RËNDËSIA E HULUMTIMIT

Tregu i punës po karakterizohet nga ndryshime të vazhdueshme si rezultat i zhvillimit teknologjik, digjitalizimit, inovacionit, ndryshimit të modeleve të biznesit dhe rritjes së konkurrencës. Këto ndryshime kanë ndikuar drejtpërdrejt në natyrën e vendeve të punës dhe në kompetencat që kërkohen nga punëdhënësit. Përveç njohurive profesionale, tregu bashkëkohor i punës kërkon gjithnjë e më shumë aftësi digjitale, analitike, komunikuese, menaxheriale, ndërpersonale, si dhe aftësi për zgjidhjen e problemeve, përshtatjen ndaj ndryshimeve dhe punën në ekip.

Në këtë kontekst, institucionet e arsimit të lartë kanë përgjegjësi të sigurojnë që programet studimore të jenë relevante dhe të përshtatura me zhvillimet e tregut të punës. Programet studimore duhet të mundësojnë jo vetëm përvetësimin e njohurive teorike, por edhe zhvillimin e kompetencave praktike dhe profesionale që u nevojiten studentëve për integrim të suksesshëm në tregun e punës.

Rëndësia e këtij hulumtimi qëndron në sigurimin e të dhënave empirike mbi kompetencat që kërkohen aktualisht nga tregu i punës dhe në identifikimin e fushave ku programet studimore mund të përmirësohen.

Rezultatet e hulumtimit mund të shërbejnë si bazë për marrjen e vendimeve lidhur me rishikimin, përditësimin dhe zhvillimin e programeve studimore, duke rritur përputhshmërinë e tyre me nevojat e punëdhënësve dhe duke kontribuar në rritjen e punësueshmërisë së të diplomuarve.

1.2. PROBLEMI I HULUMTIMIT

Një nga sfidat kryesore të institucioneve të arsimit të lartë është sigurimi i përputhshmërisë ndërmjet programeve studimore dhe nevojave në ndryshim të tregut të punës. Zhvillimet teknologjike, digjitalizimi, inteligjenca artificiale, ndryshimi i modeleve të biznesit dhe kërkesat në rritje për kompetenca profesionale dhe të transferueshme kanë krijuar nevojën për vlerësim të vazhdueshëm të relevancës së programeve studimore. Në këtë kontekst,

problemi i këtij hulumtimi lidhet me nevojën për të vlerësuar përputhshmërinë e programeve studimore të Fakultetit të Biznesit me kompetencat dhe aftësitë e kërkuara nga tregu i punës, si dhe për të identifikuar fushat ku ekziston nevojë për përmirësim dhe përshtatje.

Në veçanti, është e rëndësishme të identifikohen kompetencat që konsiderohen më të rëndësishme për punësim dhe performancë profesionale, duke përfshirë aftësitë digjitale, mendimin kritik dhe analitik, zgjidhjen e problemeve, komunikimin profesional, punën në ekip, sipërmarrjen, njohjen e gjuhëve të huaja dhe aftësinë për t'u përshtatur me zhvillimet teknologjike dhe inteligjencën artificiale.

Problemi i hulumtimit përfshin gjithashtu **vlerësimin e perceptimeve të respondentëve lidhur me nivelin e përgatitjes së studentëve dhe përputhshmërinë e programeve studimore me këto kërkesa**, me qëllim identifikimin e fushave prioritare

për përmirësimin e përmbajtjes së programeve, komponentës praktike, metodave të mësimdhënies dhe bashkëpunimit ndërmjet Fakultetit të Biznesit dhe tregut të punës.

Prandaj, nevoja për këtë hulumtim buron nga kërkesa për të siguruar të dhëna empirike që do të mundësojnë marrjen e vendimeve të argumentuara për rishikimin, përditësimin dhe zhvillimin e programeve studimore në funksion të kërkesave aktuale dhe të ardhshme të tregut të punës.

1.3. NEVOJA PËR PËRSHTATJEN E PROGRAMEVE ME TREGUN E PUNËS

Përshtatja e programeve studimore me tregun e punës është e nevojshme për të siguruar që arsimi i lartë të jetë në përputhje me zhvillimet ekonomike, teknologjike dhe profesionale. Programet studimore nuk duhet të konsiderohen si struktura statike, por si programe që kërkojnë vlerësim dhe përditësim të vazhdueshëm në funksion të ndryshimeve në tregun e punës.

Identifikimi i kompetencave të kërkuara nga punëdhënësit mundëson që përmbajtjet mësimore, rezultatet e të nxënësve, metodat e mësimdhënies dhe aktivitetet praktike të orientohen drejt nevojave reale të profesionit. Në veçanti, përfshirja më e madhe e kompetencave digjitale, analitike, praktike dhe ndërpersonale mund të ndihmojë në përgatitjen e të diplomuarve për një treg pune gjithnjë e më konkurrues dhe dinamik.

Për këtë arsye, të dhënat e siguruar nga tregu i punës përmes këtij hulumtimi mund të përdoren si një mekanizëm mbështetës për rishikimin dhe përmirësimin e programeve studimore. Kjo qasje kontribuon në forcimin e lidhjes universitet-treg i punës dhe në krijimin e programeve që reflektojnë më mirë nevojat e sektorëve ekonomikë dhe profesionalë.

1.4. QËLLIMI I HULUMTIMIT

Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi është të vlerësojë perceptimet e respondentëve lidhur me përputhshmërinë e programeve studimore të Fakultetit të Biznesit të Universitetit “Haxhi Zeka” me kërkesat aktuale të tregut të punës, si dhe të identifikojë kompetencat dhe fushat prioritare që kërkojnë përmirësim në funksion të rritjes së relevancës dhe cilësisë së programeve studimore.

1.5. OBJEKTIVAT E HULUMTIMIT

Objektivi i përgjithshëm:

Të vlerësohet përputhshmëria e programeve studimore të Fakultetit të Biznesit me kompetencat dhe kërkesat e tregut të punës, si dhe të identifikohen fushat prioritare për përmirësimin dhe përshtatjen e programeve studimore në përputhje me nevojat aktuale dhe të ardhshme të tregut të punës.

Objektivat specifike

1. Të identifikohen kompetencat dhe aftësitë që konsiderohen më të rëndësishme për tregun aktual të punës.
2. Të vlerësohet perceptimi i respondentëve mbi përputhshmërinë e programeve studimore të Fakultetit të Biznesit me kërkesat dhe kompetencat e tregut të punës.
3. Të identifikohen fushat e kompetencave në të cilat studentët perceptohen si më pak të përgatitur në raport me kërkesat e tregut të punës.
4. Të identifikohen fushat prioritare për përmirësimin dhe përditësimin e programeve studimore, duke marrë parasysh nevojat e tregut të punës.
5. Të vlerësohet rëndësia e integritit të zhvillimeve teknologjike, digjitalizimit dhe inteligjencës artificiale në programet studimore dhe në procesin e përgatitjes së studentëve.
6. Të identifikohen format e bashkëpunimit ndërmjet Fakultetit të Biznesit dhe tregut të punës që konsiderohen më të rëndësishme për zhvillimin e kompetencave praktike dhe profesionale të studentëve.
7. Të ofrohen rekomandime të bazuara në të dhënat e hulumtimit për përmirësimin, përditësimin dhe përshtatjen e programeve studimore me kërkesat aktuale dhe të ardhshme të tregut të punës.

1.6. PYETJET KËRKIMORE

- ⇒ **PK1:** Cilat kompetenca dhe aftësi konsiderohen më të rëndësishme për tregun aktual të punës?
- ⇒ **PK2:** Si vlerësohet përputhshmëria e programeve studimore të Fakultetit të Biznesit me kërkesat dhe kompetencat e tregut të punës?
- ⇒ **PK3:** Në cilat kompetenca perceptohen studentët si më pak të përgatitur në raport me kërkesat e tregut të punës?
- ⇒ **PK4:** Cilat janë fushat prioritare për përmirësimin dhe përditësimin e programeve studimore të Fakultetit të Biznesit?
- ⇒ **PK5:** Sa e rëndësishme konsiderohet përshtatja e vazhdueshme e programeve studimore me zhvillimet teknologjike, digjitalizimin dhe inteligjencën artificiale?
- ⇒ **PK6:** Cilat forma të bashkëpunimit ndërmjet Fakultetit të Biznesit dhe tregut të punës konsiderohen më të rëndësishme për përgatitjen e studentëve?

1.7. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

1.7.1. Dizajni, qasja dhe karakteri i hulumtimit

Hulumtimi është realizuar duke përdorur **qasje kuantitative**, ndërsa për nga karakteri dhe qëllimi i tij është **deskriptiv dhe vlerësues**, me fokus në identifikimin, matjen dhe vlerësimin e perceptimeve të respondentëve lidhur me kompetencat dhe aftësitë që kërkojnë nga tregu bashkëkohor i punës, si dhe në vlerësimin e shkallës së përputhshmërisë së programeve studimore të Fakultetit të Biznesit me këto kërkesa.

Qasja kuantitative është përzgjedhur për të mundësuar mbledhjen e të dhënave të strukturuar dhe të matshme përmes një pyetësori të standardizuar. Kjo qasje

mundëson përpunimin sistematik të përgjigjeve të respondentëve dhe identifikimin e tendencave, prioritetëve dhe dallimeve në perceptimet e tyre lidhur me rëndësinë e kompetencave profesionale dhe të transferueshme, nivelin e përgatitjes së studentëve, relevancën e programeve studimore dhe nevojën për përshtatjen e tyre me zhvillimet e tregut të punës.

Karakteri **deskriptiv** i hulumtimit lidhet me përshkrimin dhe paraqitjen e gjendjes së perceptuar nga respondentët në lidhje me kompetencat dhe aftësitë që konsiderohen të rëndësishme për punësim dhe zhvillim profesional. Në këtë kuadër, hulumtimi synon të evidentojë nivelin e rëndësisë së kompetencave të ndryshme, fushat në të cilat studentët perceptohen si më pak të përgatitur, shkallën e lidhjes së programeve studimore me kërkesat e tregut të punës, si dhe format e përmirësimit të cilave respondentët u japin prioritet.

Në të njëjtën kohë, hulumtimi ka **karakter vlerësues**, pasi të dhënat e mbledhura përdoren për të vlerësuar relevancën dhe përshtatshmërinë e programeve studimore në raport me nevojat aktuale dhe në zhvillim të tregut të punës. Vëmendje e veçantë i kushtohet identifikimit të fushave ku ekziston nevoja për rishikim, përditësim ose forcim të përmbajtjes dhe metodave të mësimdhënies, me qëllim që programet studimore të ofrojnë kompetenca më të përshtatshme për kërkesat e punësimit dhe zhvillimit profesional të të diplomuarve.

Në funksion të këtij qëllimi, hulumtimi është orientuar në një spektër të gjerë të **kompetencave profesionale dhe të transferueshme**, të cilat janë me rëndësi për funksionimin dhe konkurrueshmërinë e individëve në tregun bashkëkohor të punës. Këtu përfshihen, ndër të tjera, aftësitë profesionale dhe praktike, kompetencat digjitale, aftësitë analitike dhe të të menduarit kritik, komunikimi profesional, puna në ekip, zgjidhja e problemeve, aftësitë sipërmarrëse, përshtatshmëria dhe fleksibiliteti ndaj ndryshimeve, si dhe aftësia për të përdorur në mënyrë efektive teknologjitë e reja dhe mjetet e bazuara në **inteligjencën artificiale (AI)**.

Një komponent i rëndësishëm i dizajnit të hulumtimit është edhe orientimi drejt **ndryshimeve të vazhdueshme në tregun e punës**, të shkaktuara nga zhvillimet teknologjike, digjitalizimi, automatizimi, ndryshimi i modeleve të biznesit dhe transformimi i kërkesave të punëdhënësve. Për këtë arsye, vlerësimi nuk kufizohet vetëm në kompetencat që konsiderohen të nevojshme në momentin aktual, por përfshin edhe perceptimet lidhur me nevojën për përshtatje të vazhdueshme të programeve studimore ndaj kërkesave të ardhshme të tregut.

Dizajni i hulumtimit është ndërtuar në mënyrë të tillë që rezultatet e përfituara të mund të shërbejnë jo vetëm për **përshkrimin e gjendjes ekzistuese**, por edhe për identifikimin e fushave prioritare për ndërhyrje dhe përmirësim. Në këtë aspekt, të dhënat empirike krijojnë bazë për formulimin e rekomandimeve lidhur me përditësimin e lëndëve dhe përmbajtjeve mësimore, forcimin e komponentës praktike të mësimdhënies, zhvillimin e aftësive digjitale dhe analitike, zgjerimin e mundësive për praktikë profesionale dhe forcimin e bashkëpunimit ndërmjet universitetit dhe komunitetit në përgjithësi.

Në tërësi, përmes ndërthurjes së **qasjes kuantitative me karakterin deskriptiv dhe vlerësues**, hulumtimi synon të sigurojë një pasqyrë empirike të perceptimeve dhe nevojave të identifikuara, e cila mund të përdoret si bazë për **vlerësimin e relevancës së programeve ekzistuese dhe orientimin e proceseve të rishikimit, përditësimit dhe përmirësimit të tyre**.

Në këtë mënyrë, rezultatet e hulumtimit kontribuojnë në sigurimin e një lidhjeje më të qëndrueshme ndërmjet ofertës akademike të Fakultetit të Biznesit dhe kërkesave të tregut të punës, duke mbështetur zhvillimin e programeve studimore më relevante, fleksibile dhe të orientuara drejt kompetencave.

1.7.2. Popullacioni dhe mostra e hulumtimit

Popullacioni i hulumtimit përfshin respondentë të cilët, përmes përvojës së tyre akademike dhe/ose profesionale, mund të ofrojnë vlerësime relevante lidhur me kompetencat e kërkuara nga tregu i punës dhe përputhshmërinë e programeve studimore me këto kërkesa.

Mostra e hulumtimit përbëhet nga respondentët që kanë marrë pjesë në plotësimin e pyetësorit. Përfshirja e respondentëve synon të sigurojë perspektiva relevante mbi kërkesat e tregut të punës, kompetencat e nevojshme për integrim dhe zhvillim profesional, si dhe fushat në të cilat programet studimore mund të përmirësohen.

Të dhënat lidhur me strukturën e mostrës, numrin e respondentëve dhe karakteristikat e tyre do të paraqiten në kapitullin e rezultateve të hulumtimit.

Numri total i respondentëve: N = 302.

1.7.3. Instrumenti dhe procedura e mbledhjes së të dhënave

Instrumenti kryesor për mbledhjen e të dhënave ka qenë pyetësori i strukturuar, i administruar në formë elektronike përmes platformës Google Forms.

Pyetësori është hartuar në përputhje me qëllimin, objektivat dhe pyetjet kërkimore të hulumtimit. Përmbytja e tij është orientuar në identifikimin e kompetencave dhe aftësive që konsiderohen të rëndësishme për tregun e punës, vlerësimin e përputhshmërisë së programeve studimore me kërkesat e tregut, identifikimin e fushave që kërkojnë përmirësim, si dhe vlerësimin e rëndësisë së zhvillimeve teknologjike, digjitalizimit dhe inteligjencës artificiale.

Pyetësori përfshin gjithashtu aspekte që lidhen me përgatitjen praktike dhe profesionale të studentëve, nevojën për përditësimin e përmbytjeve studimore dhe rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet Fakultetit të Biznesit dhe tregut të punës.

Mbledhja e të dhënave është realizuar përmes shpërndarjes elektronike të pyetësorit, duke u mundësuar respondentëve plotësimi i tij në mënyrë të pavarur. Pjesëmarrja në hulumtim ka qenë vullnetare, ndërsa të dhënat e mbledhura janë trajtuar në mënyrë konfidenciale dhe janë përdorur vetëm për qëllimet e këtij hulumtimi.

REZULTATET E HULUMTIMIT

2. REZULTATET E HULUMTIMIT

Në këtë kapitull paraqiten rezultatet e hulumtimit të realizuar përmes pyetësorit, me fokus në vlerësimin e kompetencave dhe aftësive të kërkuara nga tregu i punës, përputhshmërinë e programeve studimore të Fakultetit të Biznesit me këto kërkesa, si dhe identifikimin e fushave prioritare për përmirësim dhe përshtatje të programeve studimore.

Rezultatet janë paraqitur dhe analizuar në përputhje me objektivat dhe pyetjet kërkimore të hulumtimit. Fillimisht paraqiten karakteristikat e respondentëve të përfshirë në hulumtim, ndërsa më pas analizohen përgjigjet e tyre lidhur me kompetencat profesionale dhe të transferueshme, nivelin e përgatitjes së studentëve, relevancën e programeve studimore dhe nevojën për përditësimin e tyre në funksion të kërkesave të tregut të punës.

Në vijim, rezultatet trajtojnë edhe rëndësinë e zhvillimeve teknologjike, digjitalizimit dhe inteligjencës artificiale, si dhe rolin e praktikës profesionale dhe bashkëpunimit ndërmjet Fakultetit të Biznesit dhe sektorit të biznesit. Nëpërmjet analizës së përgjigjeve synohet të identifikohen fushat ku programet studimore përputhen me kërkesat e tregut të punës dhe fushat ku ekziston nevoja për përmirësim, përditësim ose përshtatje të mëtejshme.

Rezultatet paraqiten në mënyrë tabelare dhe grafike, të shoqëruara me interpretimin përkatës, me qëllim që gjetjet kryesore të jenë të qarta dhe të mund të përdoren si bazë për diskutimin e rezultateve, formulimin e përfundimeve dhe hartimin e rekomandimeve për përmirësimin e programeve studimore të Fakultetit të Biznesit.

Tabela 1. Struktura e respondentëve sipas gjinisë

Kategoria	Frekuenca	Përqindja (%)
Femër	192	63.6
Mashkull	110	36.4
Gjithsej	302	100.0

Nga gjithsej **302 respondentë**, **192 (63.6%)** janë femra, ndërsa **110 (36.4%)** janë meshkuj. Të dhënat tregojnë se në **mostrën e respondentëve të përfshirë në hulumtim** mbizotërojnë respondentet femra, të cilat përbëjnë rreth dy të tretat e mostrës, ndërsa respondentët meshkuj përbëjnë pak më shumë se një të tretën. Kjo strukturë gjinore paraqet përbërjen e mostrës së respondentëve dhe merret parasysh gjatë interpretimit të rezultateve të mëtejshme.

Tabela 2. Struktura e respondentëve sipas grupmoshës


Kategoria	20–29	30–39	40–49	Nën 20	50+
Frekuenca	109	74	52	40	27
Përqindja (%)	36.1	24.5	17.2	13.2	8.9

Nga gjithsej **302 respondentë**, grupmosha **20–29 vjeç** përfaqësohet me **109 respondentë (36.1%)**, duke përbërë grupin më të madh të mostrës së respondentëve. Pas saj renditet grupmosha **30–39 vjeç**, me **74 respondentë (24.5%)**, ndërsa grupmosha **40–49 vjeç** përfaqësohet me **52 respondentë (17.2%)**. Respondentët **nën 20 vjeç** përbëjnë **40 respondentë (13.2%)**, ndërsa grupmosha **50 vjeç e lart** përfaqësohet me **27 respondentë (8.9%)**.

Në përgjithësi, të dhënat tregojnë se **mostra e respondentëve dominohet nga grupmoshat më të reja**, veçanërisht nga grupmosha 20–29 vjeç. Përfshirja e respondentëve nga grupmosha të ndryshme mundëson evidentimin e perceptimeve dhe vlerësimeve nga perspektiva të ndryshme lidhur me kompetencat dhe kërkesat e tregut të punës.

Tabela 3. Struktura e respondentëve sipas statusit profesional dhe akademik


Statusi	Frekuenca	Përqindja (%)
Student	120	39.7%
I/e punësuar në sektorin privat	56	18.5%
I/e diplomuar	56	18.5%
I/e punësuar në sektorin publik	52	17.2%
Staf akademik	37	12.3%
Menaxher	20	6.6%
Punëdhënës	19	6.3%



Nga gjithsej **302 respondentë**, pjesën më të madhe e përbëjnë **studentët (39.7%)**, pasuar nga të punësuarit në sektorin privat dhe të diplomuarit, me nga **18.5%** secili. Të punësuarit në sektorin publik përbëjnë **17.2%**, ndërsa **12.3%** e respondentëve janë staf akademik, **6.6% menaxherë** dhe **6.3% punëdhënës**.

Duke qenë se pyetja ka lejuar **përzgjedhjen e më shumë se një kategorie**, përqindjet paraqesin përqindjen e respondentëve që kanë përzgjedhur secilën kategori dhe, për këtë arsye, **nuk janë reciprokisht përjashtuese dhe nuk kanë për qëllim të japin një total prej 100%**. Të dhënat e plota paraqiten në shtojcën 1.

Tabela 4. Vlerësimi i rëndësisë së kompetencave në tregun e punës



Kompetenca	N	Mes.	DS	Med.	N1	%1	N2	%2	N3	%3	N4	%4	N5	%5
Komunikim profesional	300	4.42	0.83	5	2	0.7	9	3	27	9	85	28.3	177	59.0
Aftësi digjitale	298	4.39	0.88	5	4	1.3	10	3.4	26	8.7	85	28.5	173	58.1
Zgjidhje problemesh	298	4.39	0.88	5	5	1.7	8	2.7	26	8.7	85	28.5	174	58.4
Punë në ekip	299	4.39	0.85	5	5	1.7	8	2.7	19	6.4	101	33.8	166	55.5
Adaptim ndaj teknologjisë dhe AI	297	4.32	0.97	5	8	2.7	10	3.4	29	9.8	83	27.9	167	56.2
Gjuhë të huaja	297	4.31	0.9	5	2	0.7	14	4.7	35	11.8	84	28.3	162	54.5
Aftësi sipërmarrëse	295	4.24	0.94	4	4	1.4	14	4.7	36	12.2	94	31.9	147	49.8
Mendim kritik dhe analitik	297	4.2	0.93	4	4	1.3	14	4.7	39	13.1	102	34.3	138	46.5

Rezultatet e paraqitura në tabelë tregojnë se **të gjitha kompetencat e vlerësuara konsiderohen me rëndësi të lartë për tregun e punës**, pasi mesataret e tyre variojnë nga **4.20 deri në 4.42** në shkallën Likert 1–5. Në të gjitha rastet, medianë është **4 ose 5**, çka tregon se vlerësimet janë të përqendruara kryesisht në nivelet e larta të rëndësisë.

Komunikimi profesional rezulton si kompetenca me vlerësimin më të lartë, me **M=4.42, DS=0.83 dhe Med=5**. Rreth **59.0%** e respondentëve e kanë vlerësuar këtë kompetencë me notën 5, ndërsa **28.3%** me notën 4. Kështu, **87.3%** e respondentëve e kanë vlerësuar komunikimin profesional me notat 4 ose 5. Vetëm **3.7%** e respondentëve kanë dhënë vlerësime të ulëta (1 ose 2). Ky rezultat tregon një pajtim shumë të lartë mbi rëndësinë e aftësisë së studentëve për të komunikuar në mënyrë efektive dhe profesionale në mjedisin e punës.

Aftësitë digjitale dhe zgjidhja e problemeve kanë të njëjtën mesatare, **M=4.39**, me medianë 5. Për aftësitë digjitale, **58.1%** e respondentëve kanë dhënë notën 5 dhe **28.5%** notën 4, që nënkupton se rreth **86.6%** i konsiderojnë këto aftësi me rëndësi të lartë. Në mënyrë të ngjashme, për zgjidhjen e problemeve, **58.4%** kanë dhënë notën 5 dhe **28.5%** notën 4, duke rezultuar në **86.9%** vlerësime të nivelit 4 ose 5. Këto rezultate dëshmojnë se tregu i punës kërkon jo vetëm njohuri profesionale, por edhe aftësi për përdorimin e teknologjive dhe për zgjidhjen efektive të situatave dhe problemeve praktike.

Puna në ekip gjithashtu vlerësohet shumë lart (**M=4.39, DS=0.85, Med=5**). Rreth **55.5%** e respondentëve e kanë vlerësuar me notën 5 dhe **33.8%** me notën 4. Në total, **89.3%** e respondentëve e kanë vlerësuar këtë kompetencë me 4 ose 5, duke e bërë atë një nga kompetencat me përqendrimin më të madh të vlerësimeve të larta. Kjo gjetje nënvizon rëndësinë e aftësisë për bashkëpunim, koordinim dhe funksionim efektiv brenda ekipeve profesionale.

Adaptimi ndaj teknologjisë dhe inteligjencës artificiale (AI) ka një mesatare prej **4.32**, me **DS=0.97** dhe medianë 5. Rreth **56.2%** e respondentëve e kanë vlerësuar me notën 5 dhe **27.9%** me notën 4, ndërsa vetëm **6.1%** kanë dhënë vlerësime 1 ose 2. Rezultati tregon se aftësia për t'u përshtatur me zhvillimet teknologjike dhe përdorimin e AI konsiderohet tashmë një kompetencë e rëndësishme për përgatitjen e studentëve dhe konkurrueshmërinë e tyre në tregun bashkëkohor të punës.

Gjuhët e huaja, me **M=4.31, DS=0.90 dhe Med=5**, gjithashtu vlerësohen në nivel të lartë. Rreth **54.5%** e respondentëve kanë dhënë notën 5 dhe **28.3%** notën 4, që së bashku përbëjnë **82.8%** të vlerësimeve të larta. Kjo tregon se njohja e gjuhëve të huaja perceptohet si një kompetencë që mund të rrisë mundësitë e punësimit, komunikimin profesional dhe aftësinë e të diplomuarve për të operuar në mjedise më të gjera profesionale.

Aftësitë sipërmarrëse kanë marrë një mesatare prej **4.24**, me **DS=0.94** dhe medianë 4. Megjithatë kjo kompetencë ka një vlerësim mesatar pak më të ulët krahasuar me kompetencat e tjera, ajo vazhdon të konsiderohet me rëndësi të lartë. Rreth **49.8%** e respondentëve e kanë vlerësuar me notën 5 dhe **31.9%** me notën 4, duke rezultuar në

81.7% vlerësime të nivelit 4 ose 5. Kjo tregon rëndësinë e zhvillimit të iniciativës, kreativitetit, identifikimit të mundësive dhe aftësisë për të krijuar vlerë në treg.

Mendimi kritik dhe analitik ka marrë mesataren më të ulët ndër kompetencat e analizuara (**M=4.20, DS=0.93, Med=4**), por edhe ky rezultat mbetet brenda nivelit të lartë të rëndësisë. Rreth **46.5%** e respondentëve e kanë vlerësuar me notën 5 dhe **34.3%** me notën 4, që përbëjnë së bashku **80.8%** të vlerësimeve të larta. Rezultati tregon se aftësia për të analizuar informacionin, për të vlerësuar alternativa, për të identifikuar probleme dhe për të marrë vendime të argumentuara konsiderohet një kompetencë e rëndësishme për performancën profesionale.

Në aspektin krahasues, **komunikimi profesional** renditet i pari, i ndjekur nga **aftësitë digjitale, zgjidhja e problemeve dhe puna në ekip**. Në anën tjetër, **mendimi kritik dhe analitik** dhe **aftësitë sipërmarrëse** kanë mesataret relativisht më të ulëta, por ende shumë të larta. Diferenca ndërmjet mesatares më të lartë (**4.42**) dhe asaj më të ulët (**4.20**) është vetëm **0.22 pikë**, duke treguar se respondentët i konsiderojnë të gjitha kompetencat në mënyrë relativisht të ngjashme dhe me rëndësi të lartë.

Në përgjithësi, rezultatet evidentojnë se tregu i punës kërkon një **profil të integruar të të diplomuarit**, i cili kombinon kompetencat profesionale me aftësitë digjitale, analitike, komunikuese, ndërpersonale dhe sipërmarrëse. Për rrjedhojë, rezultatet mbështesin nevojën që programet studimore të mos përqendrohen vetëm në transmetimin e njohurive teorike, por të orientohen edhe drejt **zhvillimit të kompetencave praktike dhe të transferueshme**.

Nga perspektiva e përmirësimit të programeve studimore, këto gjetje sugjerojnë nevojën për integrimin më sistematik të këtyre kompetencave në **rezultatet e të nxënit, përmbajtjen e lëndëve dhe metodat e mësimdhënies dhe vlerësimit**. Veçanërisht, rëndësia e lartë e aftësive digjitale, adaptimit ndaj AI-së, zgjidhjes së problemeve dhe punës në ekip tregon se

programet duhet të krijojnë më shumë mundësi për punë praktike, projekte, raste studimore, punë ekipore, përdorim të teknologjive dhe zgjidhje të problemeve reale. Në këtë mënyrë, përgatitja e studentëve mund të lidhet më drejtpërdrejt me kompetencat që kërkohen dhe vlerësohen në tregun e punës.

Tabela 5. Vlerësimi i përputhshmërisë së programeve studimore me kërkesat e tregut të punës

Kategoria	Frekuenca	Përqindja (%)
Mesatarisht	142	47
Shumë	92	30.5
Plotësisht	42	13.9
Pak	17	5.6
Aspak	9	3

Rezultatet në tabelën 5 paraqesin perceptimin e respondentëve lidhur me **shkallën e përputhshmërisë së programeve studimore me kërkesat e tregut të punës**. Nga

gjithsej **302 respondentë**, përqindja më e madhe, **47.0% (142 respondentë)**, vlerëson se programet studimore i përgatisin studentët **mesatarisht** në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Ky rezultat tregon se, ndonëse programet konsiderohen pjesërisht të përshtatura me nevojat e tregut, ekziston një hapësirë e konsiderueshme për përmirësimin e kësaj përputhshmërie.

Nga ana tjetër, **30.5% (92 respondentë)** e vlerësojnë përputhshmërinë si **shumë**, ndërsa **13.9% (42 respondentë)** si **plotësisht**. Në total, **44.4%** e respondentëve kanë një vlerësim pozitiv të lartë ose shumë të lartë për përputhshmërinë e programeve me tregun e punës. Kjo tregon se një pjesë e konsiderueshme e respondentëve e konsideron përgatitjen e ofruar nga programet studimore si të përshtatshme me kërkesat e punësimit.

Në të kundërt, **5.6% (17 respondentë)** e vlerësojnë përputhshmërinë si **pak**, ndërsa vetëm **3.0% (9 respondentë)** si **aspak**. Pra, vetëm **8.6%** e respondentëve shprehin një vlerësim të ulët ose negativ. Përqindja relativisht e vogël e këtyre vlerësimeve sugjeron se ekziston një bazë e mirë e përputhshmërisë së programeve me tregun e punës, por kjo përputhshmëri nuk është ende në nivelin optimal.

Në përgjithësi, rezultatet evidentojnë një **vlerësim pozitiv, por jo plotësisht të kënaqshëm**, të programeve studimore në raport me kërkesat e tregut të punës. Dominimi i përgjigjes “mesatarisht” është veçanërisht domethënës, pasi tregon se programet kanë një nivel të caktuar relevance për tregun e punës, por kërkohet **përshtatje dhe modernizim i mëtejshëm**. Kjo nënkupton nevojën për forcimin e komponentës praktike të programeve, integrimin e kompetencave të reja profesionale dhe digjitale, si dhe një bashkëpunim më të strukturuar me punëdhënësit dhe sektorin e biznesit. Prandaj, ky rezultat mbështet konkluzionin se

rishikimi periodik i programeve studimore, në bazë të ndryshimeve në kërkesat e tregut të punës, është i domosdoshëm për të siguruar që kompetencat e fituara nga studentët të jenë sa më relevante dhe të zbatueshme në praktikë.

Tabela 6. Kompetencat në të cilat studentët perceptohen si më pak të përgatitur

Kategoria	Frekuenca	Përqindja e përgjigjeve (%)
Përvojë praktike në punë	165	54.6
Aftësi digjitale (AI, software, data)	146	48.3
Mendim kritik dhe analitik	124	41.1
Komunikim profesional	115	38.1
Punë në ekip	100	33.1
Gjuhë të huaja	97	32.1
Zgjidhje problemesh	85	28.1
Aftësi sipërmarrëse	78	25.8
Munges respekti	1	0.3




Tabela 6 paraqet perceptimet e respondentëve lidhur me kompetencat në të cilat studentët konsiderohen më pak të përgatitur për tregun e punës. Rezultatet tregojnë se **përvoja praktike në punë** përbën fushën kryesore ku evidentohen mangësi, e cila është përzgjedhur nga **165 respondentë (54.6%)**. Në vendin e dytë renditen **aftësitë digjitale**, përfshirë AI, software dhe përpunimin e të dhënave, me **146 respondentë (48.3%)**, ndërsa **mendimi kritik dhe analitik** është përzgjedhur nga **124 respondentë (41.1%)**.

Në vijim, **komunikimi profesional** është evidentuar nga **115 respondentë (38.1%)**, ndërsa **punën në ekip** e kanë identifikuar **100 respondentë (33.1%)**. Për sa i përket **gjuhëve të huaja**, ato janë përzgjedhur nga **97 respondentë (32.1%)**, ndërsa **zgjidhja e problemeve** nga **85 respondentë (28.1%)**. **Aftësitë sipërmarrëse** janë identifikuar nga **78 respondentë (25.8%)**. Vetëm **1 respondent (0.3%)** ka evidentuar mungesën e respektit si fushë ku studentët perceptohen si më pak të përgatitur.

Në përgjithësi, rezultatet nxjerrin në pah se mangësitë kryesore të perceptuara lidhen me përvojën praktike, aftësitë digjitale dhe aftësitë e të menduarit kritik dhe analitik. Këto gjetje sugjerojnë nevojën për

forcimin e komponentës praktike të programeve studimore, integrimin më të madh të teknologjive dhe mjeteve të inteligjencës artificiale në procesin mësimor, si dhe zhvillimin e kompetencave analitike dhe të zgjidhjes së problemeve.

Për këtë arsye, përshtatja e programeve studimore me kërkesat e tregut të punës duhet të fokusohet jo vetëm në njohuritë teorike, por edhe në zhvillimin e kompetencave praktike dhe të transferueshme.

Tabela 7. Fushat prioritare për përmirësimin e Fakultetit të Biznesit në funksion të tregut të punës

Kategoria	Frekuenca	Përqindja e përgjigjeve (%)
Më shumë praktikë në kompani (internship)	222	73.5
Lëndë më moderne (AI, Data Analytics, Digital Business)	156	51.7
Mësim më praktik dhe më pak teorik	155	51.3
Trajnime profesionale dhe certifikime	129	42.7
Bashkëpunim më i fortë me bizneset	123	40.7
Hapja e programeve të reja dhe inovative	94	31.1
Rritje e aftësive digjitale të studentëve	88	29.1
Rishikim i kurrikulës sipas tregut të punës	82	27.2
Përmirësim i metodave të mësimdhënies	75	24.8
Inkorporimi i gjuhës angleze si lende në semestrin e parë ose të tretë	1	0.3




Tabela 7 paraqet fushat prioritare të identifikuar nga respondentët për përmirësimin e Fakultetit të Biznesit në funksion të kërkesave të tregut të punës. Rezultatet tregojnë se prioriteti kryesor është **rritja e mundësive për praktikë në kompani (internship)**, e cila është përzgjedhur nga **222 respondentë (73.5%)**. Kjo tregon një kërkesë të

theksuar për forcimin e lidhjes ndërmjet përgatitjes akademike dhe përvojës praktike në mjedisin real të punës. Pësia e lartë e këtij rezultati tregon se përgatitja teorike, e vetme, nuk konsiderohet e mjaftueshme për sigurimin e gatishmërisë së studentëve për tregun e punës, duke e bërë përvojën praktike një komponent të rëndësishëm të zhvillimit të kompetencave profesionale.

Në vendin e dytë renditet nevoja për **lëndë më moderne**, veçanërisht në fushat e **inteligjencës artificiale (AI), Data Analytics dhe Digital Business**, e përzgjedhur nga **156 respondentë (51.7%)**. Në mënyrë të ngjashme, **51.3% e respondentëve (155)** vlerësojnë si prioritet **zhvillimin e një procesi mësimor më praktik dhe më pak teorik**. Këto rezultate evidentojnë nevojën për përditësimin e përmbajtjes së programeve dhe për një orientim më të madh të procesit mësimor drejt zbatimit praktik të njohurive. Në këtë drejtim, integrimi i teknologjive të reja dhe i qasjeve bashkëkohore në mësimdhënie mund të kontribuojë në zhvillimin e kompetencave që kërkohen gjithnjë e më shumë nga punëdhënësit.

Gjithashtu, **129 respondentë (42.7%)** kanë evidentuar nevojën për **trajnime profesionale dhe certifikime**, ndërsa **123 respondentë (40.7%)** kanë theksuar rëndësinë e **forcimit të bashkëpunimit me bizneset**. Këto gjetje sugjerojnë se zhvillimi i kompetencave të studentëve nuk duhet të kufizohet vetëm brenda kurrikulës formale, por duhet të mbështetet edhe përmes bashkëpunimit sistematik me sektorin privat dhe mundësive për zhvillim profesional. Bashkëpunimi më i strukturuar me bizneset mund të krijojë mundësi për praktika profesionale, projekte të përbashkëta, ligjërata nga profesionistë të industrisë, trajnime dhe forma të tjera të të nxënies të bazuara në përvojë.

Ndër prioritetet e tjera janë **hapja e programeve të reja dhe inovative me 31.1%, rritja e aftësive digjitale të studentëve me 29.1%, rishikimi i kurrikulës sipas kërkesave të tregut të punës me 27.2% dhe përmirësimi i metodave të mësimdhënies me 24.8%**. Vetëm **1 respondent (0.3%)** ka propozuar inkorporimin e gjuhës angleze si lëndë në semestrin e parë ose të tretë.

Në tërësi, rezultatet e kësaj tablele tregojnë se respondentët nuk e shohin përmirësimin e Fakultetit të Biznesit vetëm si një proces të ndryshimit të përmbajtjes së lëndëve, por si një **proces më të gjerë të transformimit të mënyrës së përgatitjes së studentëve për tregun e punës**. Prioriteti i lartë që i është dhënë praktikës në kompani, së bashku me kërkesën për lëndë moderne, mësim praktik, trajnime profesionale dhe bashkëpunim më të fortë me bizneset, tregon nevojën për një model arsimor më të orientuar drejt kompetencave dhe rezultateve të të nxënies. Në këtë kuadër, programet studimore duhet të krijojnë një ekuilibër më të mirë ndërmjet njohurive teorike dhe aplikimit të tyre praktik, duke përfshirë projekte reale, raste studimore, përdorimin e mjeteve digjitale dhe të AI, punën në ekip dhe zgjidhjen e problemeve. Një qasje e tillë do të mundësonte që të diplomuarit të jenë jo vetëm të pajisur me njohuri akademike, por edhe me aftësi konkrete dhe të transferueshme që rrisin gatishmërinë dhe konkurrueshmërinë e tyre në tregun e punës.

Në këtë aspekt, gjetjet e Tabelës 6 janë në përputhje edhe me rezultatet e **Tabelës 7**, ku përvoja praktike, aftësitë digjitale dhe mendimi kritik e analitik janë identifikuar si fushat kryesore në të cilat studentët perceptohen si më pak të përgatitur. Kjo përputhje

ndërmjet mangësive të identifikuara dhe prioriteteve për përmirësim e forcon argumentin për ndërhyrje konkrete në programet studimore dhe në praktikat e mësimdhënies. Prandaj,

rezultatet mund të shërbejnë si bazë për hartimin e masave institucionale që synojnë përmirësimin e kurrikulave, zgjerimin e praktikës profesionale, forcimin e partneriteteve me bizneset dhe integrimin e kompetencave digjitale dhe inovative, me qëllim rritjen e relevancës dhe përshtatshmërisë së programeve të Fakultetit të Biznesit ndaj nevojave të tregut të punës.

Tabela 8. Rëndësia e përshtatjes së vazhdueshme të programeve studimore me ndryshimet e tregut të punës

Kategoria	Frekuenca	Përqindja (%)
Shumë e rëndësishme	145	48
Shumë e domosdoshme	109	36.1
Mesatarisht e rëndësishme	39	12.9
Pak e rëndësishme	8	2.6
Aspak e rëndësishme	1	0.3




Tabela 8 paraqet vlerësimin e respondentëve lidhur me rëndësinë e përshtatjes së vazhdueshme të programeve studimore me ndryshimet dhe kërkesat e tregut të punës. Rezultatet tregojnë një **nivel shumë të lartë të pajtimit** mbi nevojën për përshtatje të vazhdueshme të programeve. Koncretisht, **145 respondentë (48.0%)** e konsiderojnë këtë përshtatje **shumë të rëndësishme**, ndërsa **109 respondentë (36.1%)** e vlerësojnë

si **shumë të domosdoshme**. Kështu, në total, **84.1% e respondentëve** e konsiderojnë përshtatjen e vazhdueshme të programeve studimore si shumë të rëndësishme ose shumë të domosdoshme.

Nga ana tjetër, **39 respondentë (12.9%)** e vlerësojnë këtë nevojë si **mesatarisht të rëndësishme**, ndërsa vetëm **8 respondentë (2.6%)** e konsiderojnë **pak të rëndësishme**. Vetëm **1 respondent (0.3%)** ka deklaruar se përshtatja e vazhdueshme e programeve studimore është **aspak e rëndësishme**. Këto rezultate tregojnë një pajtim të gjerë ndërmjet respondentëve për nevojën që programet studimore të mos mbeten statike, por të rishikohen dhe përditësohen në mënyrë periodike në përputhje me zhvillimet në tregun e punës.

Në aspektin institucional, këto gjetje nënvizojnë rëndësinë e krijimit të mekanizmave të qëndrueshëm për

monitorimin e kërkesave të tregut të punës, mbledhjen e feedback-ut nga punëdhënësit dhe të diplomuarit, rishikimin periodik të kurrikulave dhe identifikimin e kompetencave të reja profesionale.

Ndryshimet teknologjike, digjitalizimi, përdorimi i inteligjencës artificiale dhe transformimi i modeleve të biznesit krijojnë kërkesa të reja për aftësi dhe njohuri, duke e bërë përshtatjen e programeve një proces të vazhdueshëm dhe jo një ndërhyrje të njëhershme.

Në këtë drejtim, rezultatet e Tabelës 8 përforcojnë gjetjet e paraqitura në tabelat paraprahe. Ndërsa në Tabelën 6 respondentët kanë evidentuar **përvojën praktike, aftësitë digjitale dhe mendimin kritik e analitik** si fusha ku studentët perceptohen si më pak të përgatitur, në Tabelën 7 janë identifikuar si prioritete **praktika në kompani, lëndët moderne, mësimi praktik, trajnimet profesionale dhe bashkëpunimi me bizneset**. Prandaj, niveli i lartë i rëndësisë që i atribuohet përshtatjes së vazhdueshme të programeve studimore ofron një bazë të rëndësishme për orientimin e reformave të ardhshme drejt një arsimit më fleksibil, praktik, inovativ dhe të lidhur ngushtë me nevojat reale të tregut të punës.

Në përfundim, rezultatet tregojnë se përshtatja e vazhdueshme e programeve studimore perceptohet si një **kusht i rëndësishëm për ruajtjen e relevancës së arsimit universitar dhe rritjen e punësueshmërisë së të diplomuarve**.

Për Fakultetin e Biznesit, kjo nënkupton nevojën për një qasje sistematike ndaj rishikimit të programeve, në të cilën kërkesat e tregut të punës, zhvillimet teknologjike dhe nevojat e sektorit të biznesit të reflektohen në mënyrë të vazhdueshme në përmbajtjen e lëndëve, rezultatet e të nxënësve, metodat e mësimdhënies dhe mundësitë për përvojë praktike.

Tabela 9. Format e lidhjes së programeve të Fakultetit të Biznesit me tregun e punës

Kategoria	Frekuenca	Përqindja (%)
Përmes praktikës profesionale	94	31.1
Përmes bashkëpunimit me bizneset	88	29.1
Përmes lëndëve dhe kurrikulës	52	17.2
Nuk është i lidhur mjaftueshëm	42	13.9
Përmes aftësive digjitale	26	8.6




Tabela 9 paraqet perceptimet e respondentëve lidhur me mënyrën se si programet e Fakultetit të Biznesit lidhen me tregun e punës. Rezultatet tregojnë se forma kryesore e lidhjes identifikohet përmes **praktikës profesionale**, e cila është përzgjedhur nga **94 respondentë (31.1%)**. Kjo pasohet nga **bashkëpunimi me bizneset**, i cili është evidentuar nga **88 respondentë (29.1%)**. Këto dy forma së bashku përbëjnë **60.2% të përgjigjeve**, duke treguar se përvoja praktike dhe ndërveprimi i drejtpërdrejtë me sektorin e biznesit perceptohen si mekanizmat më të rëndësishëm për lidhjen e arsimit universitar me tregun e punës.

Në vijim, **52 respondentë (17.2%)** e identifikojnë lidhjen e programeve me tregun e punës përmes **lëndëve dhe kurrikulës**, ndërsa **26 respondentë (8.6%)** e lidhin atë me **zhvillimin e aftësive digjitale**. Nga ana tjetër, një pjesë e konsiderueshme e respondentëve, konkretisht **42 (13.9%)**, vlerësojnë se programet e Fakultetit të Biznesit **nuk janë të lidhura mjaftueshëm me tregun e punës**. Ky rezultat është i rëndësishëm, pasi tregon se, krahas perceptimit pozitiv për format ekzistuese të lidhjes,

ekziston ende një hapësirë e konsiderueshme për përmirësimin e relevancës së programeve studimore.

Të dhënat sugjerojnë se lidhja me tregun e punës aktualisht perceptohet më së shumti përmes **mekanizmave praktikë dhe bashkëpunimit me bizneset**, ndërsa komponentët që lidhen me përmbajtjen e kurrikulës dhe aftësitë digjitale paraqiten në nivele më të ulëta. Kjo mund të nënkuptojë nevojën për një integrim më sistematik të kërkesave të tregut të punës në hartimin dhe rishikimin e kurrikulave, si dhe për përfshirjen më të madhe të kompetencave digjitale dhe teknologjike në procesin mësimor.

*Në këtë kontekst, forcimi i lidhjes ndërmjet Fakultetit të Biznesit dhe tregut të punës nuk duhet të kufizohet vetëm në organizimin e praktikave profesionale, por duhet të zhvillohet përmes një **modeli gjithëpërfshirës të bashkëpunimit universitet–biznes**.*

Ky model mund të përfshijë përfshirjen e përfaqësuesve të biznesit në rishikimin e kurrikulave, zhvillimin e projekteve praktike, ligjërata nga profesionistë të industrisë, programe të praktikës dhe mentorimit, si dhe identifikimin periodik të kompetencave të reja të kërkuara nga punëdhënësit. Një qasje e tillë do të ndihmonte në zvogëlimin e hendekut ndërmjet njohurive akademike dhe kërkesave konkrete të tregut të punës.

Në përgjithësi, këto rezultatet janë në përputhje me gjetjet e tabelave paraprahe, veçanërisht me nevojën e identifikuar për **më shumë praktikë në kompani, mësim më praktik, lëndë moderne dhe bashkëpunim më të fortë me bizneset**.

Prandaj, forcimi i lidhjes së programeve studimore me tregun e punës duhet të konsiderohet një nga drejtimet kryesore të zhvillimit të mëtejshëm të Fakultetit të Biznesit, me synim rritjen e relevancës së programeve dhe përgatitjen e studentëve për kërkesat aktuale dhe të ardhshme të punësimit.

Tabela 10. Cili është ndryshimi më i rëndësishëm që Fakulteti i Biznesit në programet e tij duhet ta bëjë për të përgatitur më mirë studentët për tregun e punës?

Kategori	Frekuenca	Përqindja (%)
Rritja e numrit të praktikave profesionale në kompani	22	7.3
Përditësimi i programeve studimore sipas nevojave të tregut të punës	8	2.6
Integrimi më i madh i teknologjive digjitale dhe inteligjencës artificiale në mësimdhënie	2	0.7
Forcimi i bashkëpunimit me bizneset dhe institucionet publike	11	3.6
Zhvillimi i aftësive praktike përmes projekteve reale	3	1.0
Përmirësimi i aftësive të buta (komunikim, lidërsip, punë në ekip)	2	0.7
Rritja e aktiviteteve të orientimit dhe këshillimit në karrierë	3	1.0
Nxitja e sipërmarrjes dhe inovacionit	2	0.7
Rritja e mundësive për mobilitet dhe shkëmbime ndërkombëtare	3	1.0

Përmirësimi i infrastrukturës laboratorike dhe pajisjeve praktike për mësimdhënie	1	0.3
Rritja e vlerësimit të vazhdueshëm (jo vetëm provime finale)	2	0.7
Forcimi i sistemit të feedback-ut nga studentët dhe punëdhënësit	1	0.3
Rritja e projekteve ndërdisiplinare ndërmjet departamenteve	1	0.3
Rritja e punësimit pas diplomimit përmes partneriteteve strategjike me kompani	6	2.0
Zhvillimi i mentorimit nga profesorët dhe profesionistët e industrisë	1	0.3
Rritja e përdorimit të softuerëve profesionalë në lëndët specifike (p.sh. financa, marketing, analizë të dhënash)	1	0.3
Rritja e numrit të praktikave profesionale në kompani;Përditësimi i programeve studimore sipas nevojave të tregut të punës	4	1.3
Rritja e numrit të praktikave profesionale në kompani;Zhvillimi i aftësive praktike përmes projekteve reale	3	1.0
Rritja e numrit të praktikave profesionale në kompani;Forcimi i bashkëpunimit me bizneset dhe institucionet publike	3	1.0
Forcimi i bashkëpunimit me bizneset dhe institucionet publike;Zhvillimi i aftësive praktike përmes projekteve reale	2	0.7
Rritja e numrit të praktikave profesionale në kompani;Përmirësimi i aftësive të buta (komunikim, lidhësi, punë në ekip)	2	0.7
Integrimi më i madh i teknologjive digjitale dhe inteligjencës artificiale në mësimdhënie;Përmirësimi i aftësive të buta (komunikim, lidhësi, punë në ekip)	1	0.3
Forcimi i sistemit të feedback-ut nga studentët dhe punëdhënësit;Rritja e punësimit pas diplomimit përmes partneriteteve strategjike me kompani	1	0.3
Përditësimi i programeve studimore sipas nevojave të tregut të punës;Rritja e aktiviteteve të orientimit dhe këshillimit në karrierë	1	0.3
Integrimi më i madh i teknologjive digjitale dhe inteligjencës artificiale në mësimdhënie;Forcimi i bashkëpunimit me bizneset dhe institucionet publike	1	0.3
Zhvillimi i moduleve të mësimi online dhe hibride (e-learning / blended learning);Përshtatja e syllabuseve me standardet ndërkombëtare të arsimit të lartë	1	0.3
Përmirësimi i aftësive të buta (komunikim, lidhësi, punë në ekip);Rritja e projekteve ndërdisiplinare ndërmjet departamenteve	1	0.3
Rritja e numrit të praktikave profesionale në kompani;Nxitja e sipërmarrjes dhe inovacionit	1	0.3
Rritja e numrit të praktikave profesionale në kompani;Rritja e punësimit pas diplomimit përmes partneriteteve strategjike me kompani	1	0.3
Forcimi i bashkëpunimit me bizneset dhe institucionet publike;Rritja e punësimit pas diplomimit përmes partneriteteve strategjike me kompani	1	0.3
Rritja e numrit të praktikave profesionale në kompani;Integrimi më i madh i teknologjive digjitale dhe inteligjencës artificiale në mësimdhënie	1	0.3
Rritja e numrit të praktikave profesionale në kompani;Rritja e mundësive për mobilitet dhe shkëmbime ndërkombëtare	1	0.3
Forcimi i bashkëpunimit me bizneset dhe institucionet publike;Përmirësimi i aftësive të buta (komunikim, lidhësi, punë në ekip)	1	0.3
Forcimi i bashkëpunimit me bizneset dhe institucionet publike;Përfshirja e më shumë ekspertëve nga industria në procesin mësimor	1	0.3
Tri e më shumë alternativa	206	68.2
Totali	302	100.0

Të dhënat e paraqitura në tabelë tregojnë se respondentët kanë dhënë përgjigje të ndryshme lidhur me ndryshimet që Fakulteti i Biznesit duhet të ndërmarrë për përgatitjen më të mirë të studentëve për tregun e punës. Duhet të theksohet se pyetja ka lejuar **zgjedhjen e më shumë se një alternative**, prandaj frekuencat e kategorieve

nuk duhet të interpretohen si kategori ekskluzive dhe përqindjet nuk mbledhen në 100%. Në total janë regjistruar **302 përgjigje**, ndërsa **206 respondentë (68.2%) kanë përzgjedhur tri ose më shumë alternativa**, gjë që tregon se një pjesë e konsiderueshme e respondentëve e shohin nevojën për përmirësime në disa dimensione njëkohësisht.

Ndër alternativat individuale, **rritja e numrit të praktikave profesionale në kompani** paraqitet si kërkesa më e shpeshtë, me **22 përgjigje (7.3%)**. Kjo tregon se përvoja praktike në mjedise reale pune konsiderohet një nga mekanizmat më të rëndësishëm për përgatitjen e studentëve për tregun e punës. Kërkesa për praktikë shfaqet edhe në kombinim me alternativa të tjera, veçanërisht me përditësimin e programeve studimore, zhvillimin e aftësive praktike përmes projekteve reale, bashkëpunimin me bizneset dhe zhvillimin e aftësive të buta. Prania e praktikës në disa kombinime të përgjigjeve e përforcon rëndësinë e saj si një komponent që lidhet me disa fusha të tjera të përgatitjes profesionale.

Forcimi i bashkëpunimit me bizneset dhe institucionet publike renditet gjithashtu ndër kërkesat më të rëndësishme, me **11 përgjigje (3.6%)** si alternativë e vetme. Për më tepër, kjo alternativë paraqitet në kombinim me praktikën profesionale, projektet reale, punësimin pas diplomimit, zhvillimin e aftësive të buta, integrimin e teknologjisë dhe përfshirjen e ekspertëve të industrisë. Kjo tregon se respondentët e shohin bashkëpunimin me sektorin profesional jo si një aktivitet të veçantë, por si një mekanizëm që mund të mbështesë praktikën, zhvillimin e kompetencave dhe krijimin e mundësive të punësimit.

Përditësimi i programeve studimore sipas nevojave të tregut të punës është përzgjedhur nga **8 respondentë (2.6%)** si alternativë individuale dhe paraqitet edhe në kombinim me praktikën profesionale dhe orientimin në karrierë. Kjo sugjeron se respondentët presin që programet studimore të jenë më dinamike dhe të përshtaten me ndryshimet në kërkesat e tregut. Në këtë drejtim, përditësimi i kurrikulave duhet të shihet në lidhje të drejtpërdrejtë me informacionin që vjen nga punëdhënësit, zhvillimet teknologjike dhe ndryshimet në profesionet e lidhura me fushën e biznesit.

Një tjetër element me rëndësi është **rritja e punësimit pas diplomimit përmes partneriteteve strategjike me kompani**, e cila është përzgjedhur nga **6 respondentë (2.0%)** si alternativë individuale dhe shfaqet edhe në kombinim me praktikën, bashkëpunimin me bizneset dhe sistemin e feedback-ut. Kjo tregon se respondentët nuk e shohin praktikën vetëm si mundësi për fitimin e përvojës, por edhe si një **urë potenciale drejt punësimit**. Partneritetet afatgjata me kompanitë mund të krijojnë mundësi për praktika, projekte, mentorim dhe rekrutim të studentëve dhe të diplomuarve.

Alternativat **“Zhvillimi i aftësive praktike përmes projekteve reale”** dhe **“Rritja e aktiviteteve të orientimit dhe këshillimit në karrierë”** janë përzgjedhur nga **3 respondentë (1.0%)** secila, ndërsa e njëjta frekuencë vërehet edhe për **rritjen e mundësive për mobilitet dhe shkëmbime ndërkombëtare**. Këto rezultate tregojnë se përgatitja për tregun e punës perceptohet në mënyrë më të gjerë: krahas praktikës në kompani, nevojiten edhe projekte reale, mbështetje në orientimin profesional dhe ekspozim ndaj përvojave ndërkombëtare.

Në një nivel tjetër paraqiten **integrimi më i madh i teknologjive digjitale dhe inteligjencës artificiale, përmirësimi i aftësive të buta dhe rritja e vlerësimit të vazhdueshëm**, me nga **2 përgjigje (0.7%)** si alternativa individuale. Edhe pse frekuencat individuale janë relativisht të ulëta, këto tema shfaqen edhe në kombinime me alternativa të tjera. Kjo është e rëndësishme, pasi tregon se kompetencat digjitale, AI-ja dhe aftësitë e buta nuk konsiderohen të izoluara nga përgatitja praktike, por si pjesë e një profili më të plotë të kompetencave që duhet të zhvillojë studenti.

Alternativat e tjera, si **përmirësimi i infrastrukturës laboratorike dhe pajisjeve praktike, forcimi i sistemit të feedback-ut nga studentët dhe punëdhënësit, rritja e projekteve ndërdisiplinare, mentorimi nga profesorët dhe profesionistët e industrisë, përdorimi i softuerëve profesionalë, mësimi online dhe hibrid, përshtatja e syllabuseve me standardet ndërkombëtare dhe përfshirja e ekspertëve të industrisë**, kanë frekuenca më të ulëta individuale. Megjithatë, prania e tyre në përgjigje tregon se respondentët identifikojnë një spektër relativisht të gjerë faktorësh që mund të ndikojnë në përmirësimin e përgatitjes së studentëve.

Një karakteristikë veçanërisht e rëndësishme e rezultateve është fakti se **206 respondentë, ose 68.2%, kanë përzgjedhur tri ose më shumë alternativa**. Kjo është një gjetje me rëndësi për interpretimin e përgjithshëm të rezultateve, pasi sugjeron se nevoja për përmirësim nuk perceptohet vetëm në një aspekt të programeve studimore. Përkundrazi, respondentët priren të identifikojnë **disa nevoja të ndërvarura**, si praktikën profesionale, bashkëpunimin me bizneset, përditësimin e kurrikulave, zhvillimin e aftësive praktike, teknologjinë, orientimin në karrierë dhe punësimin.

Në këtë kuptim, përgjigjet sugjerojnë se përmirësimi i programeve të Fakultetit të Biznesit duhet të trajtohet si një proces i integruar. **Praktika profesionale** duhet të lidhet me **bashkëpunimin me kompanitë**; bashkëpunimi me kompanitë duhet të shfrytëzohet për **zhvillimin e projekteve reale, mentorimin dhe mundësitë e punësimit**; ndërsa përmbajtja e programeve duhet të përshtatet në mënyrë të vazhdueshme me **kompetencat profesionale dhe digjitale** që kërkohen nga tregu.

Në përmbledhje, rezultatet e kësaj pyetjeje tregojnë se prioritetet e respondentëve për përmirësimin e programeve studimore përqendrohen kryesisht në:

- *ritjen e praktikës profesionale në kompani;*
- *forcimin e bashkëpunimit me bizneset dhe institucionet;*
- *përditësimin e programeve sipas nevojave të tregut të punës;*
- *ritjen e mundësive për punësim pas diplomimit;*
- *zhvillimin e aftësive praktike përmes projekteve reale;*
- *integrimin e teknologjive digjitale dhe AI-së;*
- *zhvillimin e aftësive të buta dhe profesionale;*
- *forcimin e orientimit dhe këshillimit në karrierë;*
- *ritjen e mobilitetit dhe përvojave ndërkombëtare; dhe*
- *përmirësimin e metodave të mësimdhënies, vlerësimit, mentorimit dhe infrastrukturës.*

*Në përgjithësi, rezultatet mbështesin nevojën për një **qasje më të integruar dhe të orientuar drejt tregut të punës**, ku programet studimore nuk fokusohen vetëm në transmetimin e njohurive teorike, por në zhvillimin e një kombinimi të njohurive, aftësive praktike, kompetencave digjitale, aftësive të transferueshme dhe përvojës profesionale.*

Fakti që shumica e respondentëve kanë zgjedhur tri ose më shumë alternativa e përforcon këtë përfundim dhe tregon se përgatitja më e mirë e studentëve kërkon ndërhyrje në disa dimensione të programit dhe të përvojës së tyre universitare njëkohësisht.

2.1. Ndryshime dhe sugjerime shtesë për përmirësimin e programeve studimore

Përgjigjet e respondentëve lidhur me ndryshimet që Fakulteti i Biznesit duhet të ndërmarrë për përgatitjen më të mirë të studentëve për tregun e punës tregojnë një **nevojë të qartë për forcimin e lidhjes ndërmjet arsimit teorik dhe përvojës praktike**. Tema më e shpeshtë në përgjigjet e dhëna lidhet me kërkesën për më shumë praktikë profesionale, punë praktike në terren, ushtrime, projekte dhe mundësi për zbatimin konkret të njohurive të fituara gjatë studimeve.

Respondentët theksojnë se përgatitja e studentëve nuk duhet të mbështetet vetëm në njohuritë teorike, por duhet të përfshijë më shumë mundësi për përvojë reale profesionale. Në këtë drejtim, sugjerohet që praktika profesionale të forcohet, të strukturohet më mirë dhe, sipas disa respondentëve, të integrohet në mënyrë progresive dhe të detyrueshme gjatë viteve të studimit. Kjo kërkesë lidhet drejtpërdrejt me nevojën për rritjen e gatishmërisë së studentëve për të hyrë në tregun e punës dhe për t'u përshtatur më shpejt me kërkesat e vendeve konkrete të punës.

Një tjetër temë e rëndësishme është **forcimi i bashkëpunimit ndërmjet Fakultetit të Biznesit dhe bizneseve, institucioneve dhe industrisë**. Respondentët propozojnë krijimin e më shumë marrëveshjeve funksionale me kompani, zgjerimin e mundësive për praktika profesionale në sektorin privat dhe publik, realizimin e projekteve reale, organizimin e vizitave në kompani dhe përfshirjen e profesionistëve të industrisë në procesin mësimor. Këto sugjerime tregojnë se bashkëpunimi me tregun e punës duhet të jetë më i strukturuar dhe i vazhdueshëm, në mënyrë që studentët të fitojnë përvojë dhe të njihen me kërkesat reale profesionale që gjatë studimeve. Në të njëjtën kohë, një bashkëpunim më i ngushtë me punëdhënësit mund t'i mundësojë Fakultetit të marrë informacion të vazhdueshëm për kompetencat që kërkojnë në treg dhe t'i reflektojë ato në programet studimore.

Përgjigjet e evidentojnë gjithashtu **nevojën për modernizimin dhe përditësimin e programeve studimore**. Respondentët vlerësojnë se kurrikulat, syllabuset dhe literatura duhet të përshtaten vazhdimisht me zhvillimet e tregut të punës dhe ndryshimet në teknologji. Në veçanti, përmenden inteligjenca artificiale (AI), analiza e

të dhënave, marketingu digjital, e-commerce, softuerët profesionalë dhe teknologjitë e reja. Kjo tregon se programet studimore duhet të jenë më fleksibile dhe të afta për t'iu përgjigjur ndryshimeve të shpejta në mjedisin ekonomik dhe teknologjik.

Në këtë kontekst, **zhvillimi i kompetencave digjitale** paraqitet si një nga kërkesat me rëndësi për përmirësimin e përgatitjes së studentëve. Respondentët nuk kërkojnë vetëm njohuri bazë teknologjike, por edhe aftësi për përdorimin e mjeteve dhe softuerëve që përdoren në mjedisin bashkëkohor të biznesit. Përfshirja e AI-së, analizës së të dhënave dhe teknologjive të tjera në procesin mësimor do të mundësonte që studentët të zhvillojnë aftësi më të përshtatshme për vendimmarrje, analizë dhe zgjidhje të problemeve në organizata dhe ndërmarrje.

Një grup tjetër i rëndësishëm i përgjigjeve lidhet me **zhvillimin e aftësive profesionale dhe të transferueshme**. Përveç njohurive specifike të fushës, respondentët kërkojnë më shumë fokus në komunikimin profesional, punën në ekip, lidhshimin, mendimin kritik, zgjidhjen e problemeve, negocimin, menaxhimin e projekteve dhe sipërmarrjen. Këto sugjerime tregojnë se përgatitja për tregun e punës duhet të përfshijë një kombinim të njohurive profesionale dhe aftësive që i mundësojnë studentit të funksionojë në mënyrë efektive në një mjedis real pune. Në disa përgjigje theksohet edhe rëndësia e përmirësimit të njohurive të gjuhëve të huaja, veçanërisht të gjuhës angleze, përfshirë përdorimin e saj në kontekste profesionale.

Respondentët sugjerojnë gjithashtu **ndryshime në mënyrën e zhvillimit të procesit mësimor dhe të vlerësimit të studentëve**. Në vend të një qasjeje të dominuar nga ligjëratat dhe testet teorike, propozohet përdorim më i madh i rasteve studimore, simulimeve, projekteve reale, punës në grup, ushtrimeve praktike dhe detyrave që kërkojnë zbatimin e njohurive. Kjo qasje do t'u mundësonte studentëve të zhvillojnë jo vetëm njohuri, por edhe aftësinë për t'i përdorur ato në situata konkrete. Veçanërisht interesant është sugjerimi që gjatë praktikës profesionale performanca e studentëve të mund të vlerësohet edhe nga përfaqësuesit e kompanive, duke krijuar një lidhje më të drejtpërdrejtë ndërmjet vlerësimit akademik dhe kërkesave profesionale.

Një tjetër dimension i evidentuar në përgjigje është **përgatitja e studentëve për karrierë dhe rritja e punësueshmërisë**. Respondentët sugjerojnë më shumë orientim dhe këshillim për karrierën, përgatitje për intervista pune, mbështetje në hartimin e CV-së, aktivitete për rrjetëzim me punëdhënësit dhe informim më të mirë për mundësitë e punësimit. Këto sugjerime tregojnë se Fakulteti mund të luajë një rol më aktiv në lehtësimin e tranzicionit të studentëve nga arsimi i lartë drejt tregut të punës.

Në përgjigjet e respondentëve paraqiten edhe kërkesa për **përmirësimin e infrastrukturës dhe mjedisit akademik**. Përmenden nevoja për laboratorë dhe kabinete më të pajisura, pajisje moderne, përmirësim të platformave digjitale dhe përdorim më të madh të teknologjisë në mësimdhënie dhe vlerësim. Gjithashtu, disa

respondentë theksojnë rëndësinë e zhvillimit profesional të stafit akademik dhe përfshirjes më të madhe të ekspertëve të industrisë në procesin mësimor.

Në tërësi, përgjigjet e respondentëve tregojnë se

përmirësimi i programeve studimore nuk duhet të kufizohet vetëm në ndryshimin e përmbajtjes së lëndëve, por duhet të përfshijë edhe mënyrën se si studentët mësojnë, praktikojnë dhe zhvillojnë kompetencat e tyre.

Kërkesa për më shumë praktikë, bashkëpunim me bizneset, përditësim të kurrikulave, kompetenca digjitale, aftësi profesionale dhe orientim drejt karrierës paraqitet si një qasje e integruar për rritjen e relevancës së programeve studimore.

Në përputhje me përgjigjet e respondentëve, **shtatë fushat kryesore që kërkojnë vëmendje të mëtijshme** janë:

1. Rritja dhe strukturimi i praktikës profesionale;
2. Forcimi i bashkëpunimit me bizneset, institucionet dhe industrinë;
3. Përditësimi i kurrikulave dhe përmbajtjeve mësimore sipas kërkesave të tregut;
4. Integrimi i AI-së, teknologjisë, analizës së të dhënave dhe kompetencave digjitale;
5. Zhvillimi i aftësive profesionale dhe të transferueshme;
6. Forcimi i orientimit drejt karrierës dhe punësimit;
7. Modernizimi i metodave të mësimdhënies, vlerësimit dhe infrastrukturës akademike.

Edhe pse një numër i vogël respondentësh shprehin se janë të kënaqur me gjendjen aktuale ose nuk propozojnë ndryshime të mëtijshme, përgjigjet në tërësi japin një **mesazh të qartë për nevojën e përshtatjes së vazhdueshme të programeve studimore me zhvillimet e tregut të punës**. Në veçanti, kërkesa për përvojë praktike dhe kompetenca të aplikueshme tregon se studentët dhe të diplomuarit e shohin lidhjen ndërmjet fakultetit dhe tregut të punës si një faktor të rëndësishëm për përgatitjen e tyre profesionale.

Prandaj, gjetjet nga pyetja e hapur ofrojnë një bazë të rëndësishme për

rishikimin dhe përmirësimin e programeve studimore të Fakultetit të Biznesit,

veçanërisht në drejtim të rritjes së praktikës, modernizimit të përmbajtjeve, integritetit të teknologjive të reja dhe forcimit të bashkëpunimit me punëdhënësit. Qëllimi duhet të jetë krijimi i programeve që u ofrojnë studentëve jo vetëm njohuri akademike, por edhe **kompetenca të zbatueshme, përvojë profesionale dhe aftësi për t'iu përshtatur ndryshimeve të vazhdueshme në tregun e punës**.

2.2. SWOT ANALIZA E PROGRAMEVE STUDIMORE TË FAKULTETIT TË BIZNESIT

PIKAT E FORTA	DOBËSITË
→ Ekziston një bazë e mirë e përputhshmërisë së programeve me tregun e punës. → Programet ofrojnë bazë akademike dhe njohuri profesionale relevante. → Kompetencat profesionale dhe të transferueshme janë të integruara në programet ekzistuese. → Ekzistojnë mekanizma të bashkëpunimit me bizneset dhe praktikës profesionale. → Studentët zhvillojnë kompetenca në komunikim, punë ekipore, zgjidhje problemesh dhe fusha profesionale. → Ekziston gatishmëri e lartë për përshtatje dhe modernizim të programeve. → Ekziston potencial për bashkëpunim ndërmjet fakultetit, studentëve, të diplomuarve dhe komunitetit të biznesit.	→ Përputhshmëria me tregun e punës nuk vlerësohet ende si optimale. → Hendek ndërmjet njohurive teorike dhe përvojës praktike të studentëve. → Mundësi të pamjaftueshme për praktikë profesionale dhe ekspozim ndaj situatave reale të biznesit. → Integrimi i AI-së, Data Analytics dhe teknologjive të reja kërkon forcim të mëtijshëm. → Mësimdhënia në disa raste mund të jetë më shumë e orientuar drejt teorisë sesa praktikës. → Mekanizmat për monitorimin sistematik të ndryshimeve në tregun e punës mund të forcohen. → Nevoja për zhvillim të vazhdueshëm profesional të stafit në teknologji dhe metoda bashkëkohore të mësimdhënies.
MUNDËSITË	KËRCËNIMET
→ Zhvillimi i shpejtë i AI, Data Analytics dhe Digital Business krijon fusha të reja për modernizimin e programeve. → Mundësi për zgjerimin e partneriteteve me kompani dhe institucione. → Rritja e kërkesës për aftësi digjitale dhe profesionale krijon mundësi për programe dhe module të reja. → Mundësi për zhvillimin e praktikave profesionale, projekteve reale dhe laboratorëve të biznesit. → Mundësi për certifikime profesionale dhe trajnime në bashkëpunim me industrinë. → Mundësi për mobilitet ndërkombëtar dhe projekte të përbashkëta me universitete partnere. → Mundësi për financim përmes projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare. → Mundësi për krijimin e një modeli të qëndrueshëm universitet-biznes.	→ Ndryshimi shumë i shpejtë i kërkesave të tregut mund t'i bëjë disa kompetenca dhe përmbajtje të programeve të vjetruara. → Konkurrenca ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë për studentë dhe staf akademik. → Mospërputhja e vazhdueshme ndërmjet arsimit dhe kërkesave të industrisë mund të ndikojë në punësueshmërinë e të diplomuarve. → Kufizimet financiare dhe infrastrukturore mund të ngadalësojnë modernizimin. → Varësia nga gatishmëria e kompanive për të ofruar praktika, mentorim dhe bashkëpunim. → Emigrimi dhe largimi i studentëve dhe profesionistëve të rinj mund të ndikojë në bazën e ardhshme të kapitalit njerëzor. → Zhvillimet teknologjike mund të krijojnë kërkesa të reja për kompetenca më shpejt sesa mund të ndryshojnë programet akademike. → Ndryshimet demografike dhe ulja e numrit të studentëve potencialë mund të ndikojnë në kërkesën për programe studimore.



KONKLUZIONET, REKOMANDIMET DHE KUFIZIMET

3. KONKLUZIONET

Hulumtimi për përmirësimin e programeve studimore të Fakultetit të Biznesit në funksion të kompetencave të kërkuara nga tregu i punës ka evidentuar një sërë gjetjesh të rëndësishme lidhur me relevancën e programeve, kompetencat e nevojshme për punësim dhe fushat prioritare për përmirësim. Rezultatet tregojnë se ekziston një bazë e mirë e përputhshmërisë ndërmjet programeve studimore dhe kërkesave të tregut të punës, por kjo përputhshmëri nuk vlerësohet ende si optimale. Konkretisht, **47.0%** e respondentëve e vlerësojnë përputhshmërinë si **“mesatare”**, ndërsa **44.4%** e konsiderojnë atë **“shumë”** ose **“plotësisht”** të përshtatshme. Kjo tregon se programet ofrojnë një bazë relevante akademike, por kërkojnë përshtatje dhe modernizim të mëtejshëm.

Një nga gjetjet kryesore të hulumtimit është **rëndësia shumë e lartë që respondentët i atribuojnë kompetencave profesionale dhe të transferueshme**. Të gjitha kompetencat e analizuar kanë marrë vlerësime të larta, me mesatare ndërmjet 4.20 dhe 4.42 në shkallën 1–5. Komunikimi profesional renditet si kompetenca më e rëndësishme, pasuar nga aftësitë digjitale, zgjidhja e problemeve dhe puna në ekip. Në të njëjtën kohë, adaptimi ndaj teknologjisë dhe inteligjencës artificiale, gjuhët e huaja, aftësitë sipërmarrëse dhe mendimi kritik e analitik konsiderohen gjithashtu kompetenca të rëndësishme për suksesin profesional.

Nga ana tjetër, rezultatet evidentojnë një hendek ndërmjet rëndësisë së këtyre kompetencave dhe nivelit të përgatitjes së studentëve. Mangësia kryesore perceptohet te përvoja praktike në punë, e identifikuar nga 54.6% e respondentëve, e ndjekur nga aftësitë digjitale me 48.3% dhe mendimi kritik dhe analitik me 41.1%. **Këto gjetje tregojnë se studentët kanë nevojë për më shumë mundësi për zbatimin praktik të njohurive, përdorimin e teknologjive dhe zhvillimin e aftësive analitike.**

Në këtë drejtim, **praktika profesionale** paraqitet si ndërhyrja me prioritetin më të lartë. Rreth 73.5% e respondentëve kërkojnë më shumë mundësi për praktikë në kompani, ndërsa mbi gjysma kërkojnë lëndë më moderne në fusha si AI, Data Analytics dhe Digital Business (51.7%) dhe një proces mësimor më praktik e më pak teorik (51.3%). Gjithashtu, rëndësi të konsiderueshme i kushtohet trajnimeve profesionale dhe certifikimeve (42.7%) dhe forcimit të bashkëpunimit me bizneset (40.7%).

Rezultatet tregojnë gjithashtu se lidhja aktuale e programeve me tregun e punës realizohet kryesisht përmes praktikës profesionale dhe bashkëpunimit me bizneset, të cilat së bashku përbëjnë 60.2% të përgjigjeve. Megjithatë, 13.9% e respondentëve vlerësojnë se programet nuk janë të lidhura mjaftueshëm me tregun e punës.

Kjo dëshmon se ekzistojnë mekanizma të lidhjes universitet–treg pune, por ato duhet të bëhen më sistematike, të strukturuar dhe të integruara në procesin e zhvillimit të programeve.

Një gjetje tjetër me rëndësi strategjike është pajtimi i lartë mbi nevojën për përshtatje të vazhdueshme të programeve studimore. 84.1% e respondentëve e konsiderojnë këtë përshtatje “shumë të rëndësishme” ose “shumë të domosdoshme”. Për këtë arsye, rishikimi i programeve nuk duhet të trajtohet si proces i njehershëm, por si një proces

i vazhdueshëm i monitorimit të tregut të punës, mbledhjes së feedback-ut nga punëdhënësit dhe të diplomuarit dhe përditësimit të kompetencave, përmbajtjeve dhe metodave të mësimdhënies.

Në përfundim, hulumtimi dëshmon se përmirësimi i programeve studimore të Fakultetit të Biznesit duhet të orientohet drejt një modeli më praktik, inovativ, digjital dhe të lidhur ngushtë me sektorin e biznesit.

Programet duhet të sigurojnë një ekuilibër më të mirë ndërmjet njohurive teorike dhe zbatimit praktik, duke integruar projekte reale, raste studimore, teknologji dhe AI, punë ekipore, zgjidhje problemesh dhe zhvillim të aftësive profesionale. Një qasje e tillë do të kontribuonte në rritjen e relevancës së programeve, përmirësimin e përgatitjes së studentëve dhe rritjen e punësueshmërisë dhe konkurrueshmërisë së të diplomuarve në tregun e punës.

Prandaj, gjetjet e këtij hulumtimi ofrojnë një bazë të argumentuar për ndërmarrjen e masave konkrete në drejtim të

rishikimit të kurrikulave, zgjerimit të praktikës profesionale, forcimit të partneriteteve me bizneset, integrimin të kompetencave digjitale dhe AI-së, modernizimit të metodave të mësimdhënies dhe forcimit të orientimit drejt karrierës dhe punësimit.

4. REKOMANDIMET

Bazuar në rezultatet e hulumtimit, rekomandohen këto masa për përmirësimin dhe përshtatjen e programeve studimore të Fakultetit të Biznesit:

1. Rritja dhe strukturimi i praktikës profesionale

Duke qenë se 73.5% e respondentëve e kanë identifikuar praktikën në kompani si prioritetin kryesor, rekomandohet zgjerimi i mundësive për praktikë profesionale dhe krijimi i një sistemi më të strukturuar të menaxhimit të saj. Praktika duhet të lidhet drejtpërdrejt me kompetencat dhe rezultatet e të nxënit të programeve dhe të shoqërohet me mentorim dhe vlerësim të studentëve.

2. Forcimi i bashkëpunimit universitet–biznes

Rekomandohet krijimi dhe zgjerimi i partneriteteve afatgjata me kompani, institucione dhe organizata profesionale. Përfaqësuesit e industrisë duhet të përfshihen më aktivisht në rishikimin e kurrikulave, zhvillimin e projekteve praktike, ligjëratat profesionale, mentorimin dhe identifikimin e kompetencave të reja të kërkuara nga tregu.

3. Përditësimi periodik i programeve dhe kurrikulave

Rekomandohet që programet studimore të rishikohen në mënyrë periodike në bazë të ndryshimeve në tregun e punës, zhvillimeve teknologjike dhe feedback-ut të punëdhënësve, të diplomuarve, studentëve dhe stafit akademik. Përditësimi duhet të fokusohet jo vetëm në titujt e lëndëve, por edhe në përmbajtje, rezultatet e të nxënit dhe kompetencat e synuara.

4. Integrimi i AI-së, teknologjisë dhe analizës së të dhënave

Rekomandohet përfshirja më e madhe e inteligjencës artificiale, Data Analytics, Digital Business dhe mjeteve të tjera digjitale në programet ekzistuese, si dhe vlerësimi i mundësisë për zhvillimin e lëndëve ose moduleve të reja në këto fusha. Kjo është veçanërisht e rëndësishme duke pasur parasysh kërkesën e respondentëve për lëndë më moderne.

5. Kalimi drejt mësimdhënies më praktike dhe të orientuar drejt kompetencave

Rekomandohet rritja e përdorimit të rasteve studimore, projekteve reale, simulimeve, detyrave praktike, punës ekipore dhe zgjidhjes së problemeve. Procesi i mësimdhënies duhet të krijojë më shumë mundësi që studentët të aplikojnë njohuritë teorike në situata reale të biznesit.

6. Zhvillimi sistematik i aftësive profesionale dhe të transferueshme

Programet duhet të integrojnë në mënyrë më të dukshme komunikimin profesional, punën në ekip, mendimin kritik dhe analitik, zgjidhjen e problemeve, aftësitë

sipërmarrëse dhe aftësinë për përshtatje me ndryshimet teknologjike. Këto kompetenca duhet të reflektohen në rezultatet e të nxënit dhe në mënyrën e vlerësimit të studentëve.

7. Zhvillimi i trajnimeve profesionale dhe certifikimeve

Rekomandohet organizimi i trajnimeve, punëtorive dhe mundësive për certifikime profesionale, në bashkëpunim me kompani dhe institucione profesionale. Këto aktivitete mund të plotësojnë kompetencat e fituara përmes kurrikulës formale dhe të rrisin konkurrueshmërinë e studentëve në tregun e punës.

8. Forcimi i orientimit dhe këshillimit në karrierë

Rekomandohet forcimi i shërbimeve të orientimit në karrierë, përfshirë përgatitjen e studentëve për intervista pune, hartimin e CV-së, zhvillimin e aftësive për kërkim pune, organizimin e aktiviteteve të rrjetëzimit dhe krijimin e kontakteve të drejtpërdrejta me punëdhënësit.

9. Krijimi i një mekanizmi të rregullt për monitorimin e tregut të punës

Rekomandohet krijimi i një mekanizmi institucional për mbledhjen dhe analizimin periodik të të dhënave mbi kërkesat e tregut të punës. Ky mekanizëm mund të përfshijë anketime të rregullta me punëdhënësit, të diplomuarit dhe studentët, analiza të vendeve të punës dhe konsultime me përfaqësues të industrisë.

10. Përmirësimi i metodave të vlerësimit

Rekomandohet rritja e përdorimit të vlerësimit të vazhdueshëm dhe të metodave që matin aplikimin e njohurive dhe zhvillimin e kompetencave, krahas provimeve tradicionale. Projektet, prezantimet, rastet studimore, detyrat praktike dhe puna ekipore mund të përdoren më gjerësisht si forma të vlerësimit.

11. Zhvillimi profesional i stafit akademik

Rekomandohet që stafi akademik të ketë mundësi të rregullta për zhvillim profesional në fusha si teknologjitë e reja, AI, metodat bashkëkohore të mësimdhënies, Data Analytics, inovacioni dhe kërkesat e reja të industrisë. Kjo do të ndihmonte në sigurimin e një procesi mësimor më bashkëkohor dhe më të orientuar drejt tregut.

12. Përmirësimi i infrastrukturës dhe mjedisit të të nxënit

Rekomandohet investimi në laboratorë, pajisje praktike, platforma digjitale dhe mjete teknologjike që mundësojnë zhvillimin e aftësive praktike dhe digjitale të studentëve. Infrastruktura duhet të mbështesin përdorimin e teknologjive dhe metodave moderne të mësimdhënies.

13. Forcimi i mundësive për projekte reale dhe ndërdisiplinare

Rekomandohet zhvillimi i projekteve të përbashkëta me kompani dhe institucione, ku studentët do të mund të punojnë mbi probleme reale të biznesit. Gjithashtu, duhet të

nxitet bashkëpunimi ndërmjet departamenteve dhe programeve për zhvillimin e projekteve ndërdisiplinare.

14. Rritja e mundësive për mobilitet dhe përvoja ndërkombëtare

Rekomandohet zgjerimi i mundësive për mobilitet akademik, shkëmbime ndërkombëtare, praktika profesionale dhe aktivitete të përbashkëta me universitete dhe institucione partnere. Përvojat ndërkombëtare mund të kontribuojnë në zhvillimin e kompetencave profesionale, gjuhësore dhe ndërkulturore të studentëve.

15. Vendosja e një cikli të vazhdueshëm të përmirësimit

Në nivel institucional, rekomandohet që përmirësimi i programeve të bazohet në një cikël të vazhdueshëm të monitorimit, vlerësimit, ndërhyrjes dhe rishikimit. Në këtë mënyrë, rezultatet e feedback-ut nga tregu i punës, studentët dhe të diplomuarit duhet të përdoren për ndërmarrjen e masave konkrete dhe për vlerësimin e efektivitetit të tyre.

Në tërësi, rekomandimet synojnë që Fakulteti i Biznesit të kalojë nga një model ku lidhja me tregun e punës realizohet kryesisht përmes praktikës profesionale dhe bashkëpunimeve individuale, drejt një

modeli të integruar universitet–biznes,

ku kërkesat e tregut reflektohen në kurrikulë, mësimdhënie, vlerësim, praktikë profesionale, zhvillim të stafit dhe orientim në karrierë. Kjo qasje është në përputhje me gjetjen kryesore të hulumtimit se përmirësimi i programeve nuk duhet të kufizohet vetëm në ndryshimin e përmbajtjes së lëndëve, por duhet të përfshijë mënyrën se si studentët mësojnë, praktikojnë dhe zhvillojnë kompetencat e tyre.

5. KUFIZIMET E HULUMTIMIT

Si çdo hulumtim empirik, edhe ky studim ka disa kufizime që duhet të merren në konsideratë gjatë interpretimit të rezultateve dhe përgjithësimit të gjetjeve. Këto kufizime lidhen kryesisht me karakteristikat e mostrës, natyrën e të dhënave të mbledhura, dizajnin e hulumtimit dhe fokusin institucional të studimit.

1. Përbërja dhe përfaqësimi i mostrës

Një nga kufizimet kryesore lidhet me përbërjen e mostrës së respondentëve. Mostra përfshin kategori të ndryshme respondentësh, përfshirë studentë, të diplomuar, të punësuar në sektorin publik dhe privat, menaxherë dhe staf akademik. Kjo përbërje mundëson një perspektivë të gjerë mbi përputhshmërinë e programeve me tregun e punës, por përfaqësimi i kategorive nuk është domosdoshmërisht proporcional me peshën e tyre në popullatën përkatëse.

2. Mbështetja në perceptimet e respondentëve

Të dhënat e hulumtimit bazohen kryesisht në perceptimet dhe vlerësimet subjektive të respondentëve. Për shembull, vlerësimi i rëndësisë së kompetencave, nivelit të përgatitjes së studentëve dhe përputhshmërisë së programeve me tregun e punës pasqyron perceptimin e respondentëve dhe jo domosdoshmërisht një matje objektive të kompetencave reale të studentëve apo të kërkesave të dokumentuara të punëdhënësve. Kjo nënkupton se rezultatet mund të ndikohen nga përvoja, pritjet dhe perspektiva individuale e respondentëve.

3. Natyra ndërsektoriale e hulumtimit

Hulumtimi është realizuar në një moment të caktuar kohor dhe ka karakter kryesisht deskriptiv dhe vlerësues. Për këtë arsye, rezultatet paraqesin situatën dhe perceptimet e respondentëve në periudhën kur është realizuar hulumtimi, ndërsa nuk mund të përcaktojnë në mënyrë të plotë se si këto perceptime do të ndryshojnë me kalimin e kohës. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në kontekstin e teknologjisë, inteligjencës artificiale dhe aftësive digjitale, ku kërkesat e tregut të punës ndryshojnë me ritëm të shpejtë.

4. Kufizimi i të dhënave të mbledhura për kërkesën reale të tregut të punës

Hulumtimi fokusohet në perceptimet e respondentëve lidhur me kompetencat e kërkuara dhe përputhshmërinë e programeve studimore, por nuk përfshin në mënyrë të drejtpërdrejtë një analizë sistematike të të dhënave objektive të tregut të punës, siç janë shpalljet e vendeve të punës, kërkesat konkrete të punëdhënësve sipas profesioneve, të dhënat e punësimit të të diplomuarve apo statistikat sektoriale. Përfshirja e këtyre burimeve do të mundësonte një vlerësim edhe më të plotë të hendekut ndërmjet kompetencave të ofruara nga programet dhe kërkesave reale të tregut.

5. Kufizimi i analizës në nivelin deskriptiv dhe vlerësues

Hulumtimi është orientuar kryesisht drejt identifikimit dhe përshkrimit të perceptimeve, prioriteteve dhe fushave për përmirësim. Për këtë arsye, rezultatet nuk synojnë të përcaktojnë marrëdhënie shkak-pasojë ndërmjet ndryshimit të programeve studimore dhe punësueshmërisë së të diplomuarve. Për shembull, gjetja se praktika profesionale konsiderohet ndërhyrja më e rëndësishme nuk dëshmon në vetvete se rritja e praktikës do të shkaktojë drejtpërdrejt rritje të punësueshmërisë.

6. Kufizimi i fokusit institucional

Hulumtimi është i fokusuar në programet studimore të Fakultetit të Biznesit dhe në perceptimet e respondentëve lidhur me këto programe. Për këtë arsye, gjetjet janë veçanërisht të vlefshme për kontekstin institucional të studimit, ndërsa përgjithësimi i tyre në fakultete të tjera, universitete të tjera ose në sistemin e arsimit të lartë në Kosovë duhet të bëhet me kujdes, duke marrë parasysh dallimet në programe, profile akademike dhe karakteristikat e tregut të punës.

7. Dinamika e shpejtë e ndryshimeve teknologjike

Një kufizim i rëndësishëm lidhet me natyrën dinamike të kompetencave digjitale dhe teknologjike. Kërkesat lidhur me inteligjencën artificiale, Data Analytics, Digital Business dhe teknologjitë e tjera mund të ndryshojnë shpejt. Prandaj, kompetencat dhe fushat prioritare të identifikuara në këtë hulumtim duhet të konsiderohen si një pasqyrë e nevojave të tregut në periudhën e studimit dhe jo si një listë statike dhe afatgjatë e kompetencave.

Përfundimi

Pavarësisht këtyre kufizimeve, hulumtimi ofron një **bazë të rëndësishme empirike për identifikimin e perceptimeve dhe prioriteteve lidhur me përmirësimin e programeve studimore**. Kufizimet e evidentuara nuk e zvogëlojnë vlerën e gjetjeve, por përcaktojnë kuadrin brenda të cilit ato duhet të interpretohen. Në të njëjtën kohë, këto kufizime krijojnë mundësi për hulumtime të ardhshme, veçanërisht përmes përfshirjes më të gjerë të punëdhënësve, analizës së të dhënave objektive të tregut të punës, krahasimit ndërmjet programeve dhe realizimit të hulumtimeve të përsëritura në periudha të ndryshme kohore për të monitoruar ndryshimet në kërkesat e tregut të punës dhe kompetencat e kërkuara.

6. SHTOJCA

→ **Shtojca 1. Struktura e respondentëve sipas statusit profesional dhe akademik**

Kategoria	Frekuenca	Përqindja (%)
Student	96	31.8
I punësuar në sektorin publik	35	11.6
I punësuar në sektorin privat	32	10.6
Staf akademik	31	10.3
I/e diplomuar	30	9.9
Menaxher	13	4.3
Punëdhënës	10	3.3
Student;I punësuar në sektorin privat	9	3
I/e diplomuar;I punësuar në sektorin publik	6	2
Student;I punësuar në sektorin publik	5	1.7
Student;I/e diplomuar	5	1.7
Student;I/e diplomuar;I punësuar në sektorin privat	3	1
I/e diplomuar;Punëdhënës	3	1
I/e diplomuar;I punësuar në sektorin privat	3	1
Punëdhënës;Menaxher;I punësuar në sektorin privat	3	1
Student;I/e diplomuar;I punësuar në sektorin publik	2	0.7
Staf akademik;I punësuar në sektorin privat	2	0.7
Staf akademik;I punësuar në sektorin publik	2	0.7
Doktorant	1	0.3
I/e diplomuar;Menaxher;I punësuar në sektorin privat	1	0.3
I/e diplomuar;	1	0.3
Punëdhënës;	1	0.3
Menaxher;E punësuar ne OJQ	1	0.3
Pronare	1	0.3
I/e diplomuar;Staf akademik	1	0.3
I/e diplomuar;Punëdhënës;Menaxher;I punësuar në sektorin privat	1	0.3
I pensionuar	1	0.3
Menaxher;I punësuar në sektorin privat	1	0.3
I punësuar në sektorin privat;I punësuar në sektorin publik	1	0.3
Staf akademik;Punëdhënës;I punësuar në sektorin publik	1	0.3

→ **Vegëza e pyetësorit online**

https://docs.google.com/forms/d/e/1FAIpQLSdOg9d-4oGviPwYTMtjn_esXdorXbdh8_LLUvOuVUEguKCrGQ/viewform?usp=header

SHËNIM INSTITUCIONAL MBI REALIZIMIN E HULUMTIMIT

Ky hulumtim është realizuar në kuadër të aktiviteteve institucionale të Fakultetit të Biznesit, me qëllim të vlerësimit të përputhshmërisë së programeve studimore me kompetencat, aftësitë dhe njohuritë e kërkuara nga tregu i punës. Hulumtimi synon të ofrojë një bazë të argumentuar për identifikimin e nevojave për përmirësimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të programeve studimore, duke marrë në konsideratë ndryshimet në kërkesat e tregut të punës dhe pritshmëritë e punëdhënësve.

Realizimi i këtij hulumtimi është bërë gjatë mandatit të menaxhmentit të Fakultetit të Biznesit, në përbërje nga:

- 1. Prof. asoc. dr. Ylber Januzaj – Dekan**
- 2. Prof. asoc. dr. Suada Ajdarpašić – Prodekane për mësimdhënie dhe çështje akademike**
- 3. Prof. ass. dr. Driton Sylqa – Prodekan për çështje financiare dhe infrastrukturë**

Hulumtimi paraqet një nga aktivitetet e ndërmarra nga Fakulteti i Biznesit në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së arsimit, forcimit të lidhjes ndërmjet arsimit të lartë dhe tregut të punës, si dhe avancimit të programeve studimore në përputhje me zhvillimet dhe nevojat e ekonomisë dhe shoqërisë.

Të dhënat dhe gjetjet e këtij hulumtimi synohet të shërbejnë si bazë për orientimin e proceseve të ardhshme të rishikimit dhe zhvillimit të programeve studimore, si dhe për forcimin e bashkëpunimit ndërmjet Fakultetit të Biznesit, studentëve, të diplomuarve dhe komunitetit të biznesit.

Ky raport dokumenton një aktivitet të rëndësishëm institucional të Fakultetit të Biznesit dhe përbën një kontribut në procesin e planifikimit, sigurimit të cilësisë dhe zhvillimit të vazhdueshëm akademik.

Periudha e realizimit të hulumtimit: Maj – Shtator 2026